



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Nr. 1137/1 Prot.

Durrës, më 5.7.2023

VENDIM

Nr. 38, datë 5.7 2023

"Për miratimin e strukturës së nivelit të pagave për personelin administrativ dhe mbështetës të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës"

Në zbatim të nenit 3 pika 1, nenit 49, nenit 67 ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 6, nenit 10 të ligjit nr. 35/2023, "Kompetencat për caktimin e pagave, të trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve", neni 5 pika 4 gërma d, nenit 34 pika 1 gërma k e Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, Udhëzimin nr.16 datë 16.06.2023 "Për mënyrën e zbatimit të Vendimi të Këshillit të Ministrave nr.325 datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të Administratës Publike", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës së nivelit të pagave për personelin administrativ dhe mbështetës të Universitetit Aleksandër Moisiu, sipas lidhjeve bashkëlidhur këtij vendimi:
 - Lidhja nr.1 Klasifikimi i nivelit të pagave për personelin administrativ dhe mbështetës
 - Lidhja nr.2 Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit
 - Lidhja nr.3 Shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune)
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë që nga data 01.04.2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtoria Administrimit Financiar
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

